

Vendim nr. 261 datë 22.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (J) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: JONELA SULAJ, përfaqësuar nga avokat Taulant Asllanaj, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: Rivendosja e së drejtës për të paraqitur ankim kushtetues individual.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 9653, datë 30.09.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2023-3565 (540), datë 27.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është një ndër trashëgimtarët ligjorë të babait të saj, i cili ka humbur jetën nga një aksident i shkaktuar nga një drejtues mjeti motorik. Mjeti motorik ka qenë i siguruar pranë shoqërisë së sigurimit “Atlantik” sh.a. (*shoqëria e sigurimit*). Drejtuesi i mjetit motorik është deklaruar fajtor me vendimin nr. 865, datë 29.09.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Në vijim, kërkuesja dhe trashëgimtarët e tjerë i janë drejtuar shoqërisë së sigurimit për përfitimin e shpërblimit të dëmit nga humbja e jetës së familjarit të tyre nga aksidenti me mjetin motorik. Duke mos qenë dakord me shumën e ofruar nga shoqëria e sigurimit, në datën 07.02.2006, ata kanë ngritur padi në gjykatë për shpërblimin e dëmit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5740, datë 19.07.2007, ka pranuar padinë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit t’i shpërblejë trashëgimtarët e të ndjerit me vlerën 3.878.600 lekë dhe kamatat respektive. Vendimi është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1416, datë 05.09.2008 dhe çështja është kthyer për rigjykim për shkak të parregullsive procedurale në marrjen e provave, përfshirë atë të ekspertit. Në rigjykim, gjykimi i çështjes është pushuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 3119, datë 16.04.2010, por sërish vendimi është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 498, datë 18.11.2010, e cila ka urdhëruar rigjykimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë.

4. Në përfundim të rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9653, datë 30.09.2013, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit t’i paguajnë trashëgimtarëve të të ndjerit shpërblimin prej 1.342.245 lekësh për dëmin e shkaktuar dhe kamatat respektive. Mbi bazën e ankimit të tyre, vendimi është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 1627, datë 30.06.2015, ka vendosur detyrimin e shoqërisë së sigurimit t’i shpërblejë trashëgimtarët me vlerën prej 4.544.638 lekësh, që përfshinte dëmin e shkaktuar dhe interesat. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar rekurs të gjitha palët dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3565, datë 27.09.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Në datën 01.07.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, të përpiluar me ndihmën e avokatit, duke kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të gjykatës së apelit (për atë pjesë që kishte rrëzuar kërkimet e padisë) dhe të vendimit të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 240, datë 18.10.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në

seancë plenare, me arsyetimin se ankimi kushtetues individual ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

6. Pas marrjes së vendimit, konkretisht në datën 17.01.2025, kërkesja i është drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë (*DHASH*) me kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj avokatit për shkak të shërbimit profesional të papërshtatshëm, me pasoja të rënda në ecurinë e procesit të saj gjyqësor. Ajo ka parashtruar se avokati e kishte këshilluar t'i drejtohej Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) për kundërshtimin e vendimit të gjykatave të zakonshme, pa iu drejtuar më parë Gjykatës dhe, pas marrjes së njoftimit nga GJEDNJ-ja për detyrimin e shterimit të mjeteve juridike të brendshme, të paraqiste ankim kushtetues individual. Për këtë shkak, ankimi i saj është vlerësuar jashtë afatit ligjor 4-mujor nga Kolegji i Gjykatës. Komisioni Disiplinor pranë DHASH-së, me vendimin nr. 364, datë 09.04.2025, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj avokatit, duke e detyruar t'i kthente kërkeses edhe shumat e paguara për përfaqësimin ligjor.

7. Në datën 09.09.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkeses

8. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

8.1. Ankimi kushtetues individual duhet të rivendoset në afatin ligjor 4-mujor, pasi humbja e tij është rrjedhojë e veprimeve joprofesionale të avokatit që vërtetohet edhe nga masa disiplinore. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i është njoftuar avokatit në adresën e kontaktit elektronik, të depozituar në dosjen gjyqësore. Kërkesja i është drejtuar disa herë Gjykatës së Lartë për të marrë informacion, të cilin e ka marrë vetëm në datën 22.02.2024, në rrugë elektronike.

8.2. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.2.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykata e shkallës së parë është bazuar në aktin e ekspertimit të një eksperti që kishte bashkëpunuar me shoqërinë e sigurimit. Edhe Gjykata e Lartë ka qenë e njëanshme kur ka arsyetuar se në padi nuk është kërkuar dëmi jopasuror.

8.2.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse është gjykatë ligji, ka konkluduar vetëm mbi faktet dhe ka bërë

vlerësim të provave, duke anashkaluar aktin e ekspertimit të kryer në gjykimin në shkallë të dytë, si dhe duke mos trajtuar pretendimet e kërkuases.

8.2.3. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi refuzimi i pretendimit në rekurs për njëanshmërinë e ekspertit e ka vendosur kërkuesen në pozitë të disfavorshme ndaj palës tjetër. Eksperti nuk ka konsideruar faktin që i ndjeri përfitonte pension pleqërie dhe pension suplementar ushtarak. Gjykatat kanë vlerësuar vetëm ekspertimin në favor të shoqërisë së sigurimit.

8.2.4. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar se dëmi jopasuror nuk ishte kërkuar nga paditësit, ndonëse kërkimi pasqyrohej në marrëveshjen me shoqërinë e sigurimit dhe ishte llogaritur në të dyja ekspertimet. Gjykatat nuk kanë dhënë arsye se përse një akt ekspertimi prevalon ndaj tjetrit. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit në rekurs për njëanshmërinë e gjykatës së shkallës së parë dhe nuk ka kontrolluar zbatimin e ligjit procedural prej saj. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i paqartë, jologjik dhe kontradiktor, pasi, ndërsa ka arsyetuar se vlerësimi i provave nuk përfshihet në juridiksionin e saj, ka vlerësuar aktet e ekspertimit, duke i dhënë të drejtë gjykatës së rrethit.

8.2.5. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykimi i çështjes në gjykatat e zakonshme ka zgjatur rreth 20 vjet, ndërsa në Gjykatën e Lartë rreth 8 vjet. Kohëzgjatja e gjykimit nuk ka qenë rrjedhojë e kompleksitetit të çështjes ose veprimeve të kërkuases.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuases

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës edhe më parë, duke kërkuar, ndër të tjera, edhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 240, datë 18.10.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se ankimi kushtetues individual ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

11. Kërkesja ka paraqitur ankimin e dytë të saj, me kërkimin e rivendosjes në afat, duke parashtruar se humbja e afatit ligjor është rezultat i sjelljes joprofesionale të avokatit të saj, për të cilën ai ka marrë masën disiplinore të vërejtjes me shkrim. Po kështu, kërkesja ka parashtruar se afati ligjor 4-mujor duhet të rillogaritet duke mbajtur në konsideratë se Gjykata e Lartë nuk ia ka njoftuar avokatit të saj në rrugë elektronike vendimin, pavarësisht depozitimit të të dhënave të kontaktit dhe se Gjykata e Lartë e ka njoftuar atë vetëm në datën 22.02.2024, pas kërkesës së saj.

12. Në parantezë, Kolegji vë në dukje se problematikat në marrëdhënien midis avokatit të zgjedhur dhe individit nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm kushtetues për pranimin e ankimit kushtetues individual. Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se strategjia e mbrojtjes që ka të bëjë me mënyrën sesi avokati zgjedh të realizojë mbrojtjen mbetet një çështje midis individit dhe avokatit, si e tillë ajo nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 83, datë 05.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në vijim, Kolegji vëren se ankimi kushtetues individual i parë është paraqitur nga kërkesja në datën 01.07.2024, për të cilin Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 240, datë 18.10.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor. Gjykata ka pohuar se vendimet e Kolegjeve të saj, të dhëna në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesës, nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as nga vetë Gjykata (*shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga kjo pikëpamje, Kolegji thekson se çështja që kërkesja ka humbur afatin ligjor 4-mujor për të paraqitur ankimin kushtetues individual nuk mund të rishikohet më nga Gjykata, pasi ka marrë formën e gjësë së gjykuar (*res judicata*). Me fjalë të tjera, kërkitimi për të vlerësuar afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual ka qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të Kolegjit, ndaj sipas nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000 duhet vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Megjithatë, kërkesja për kundërshtimin e këtij vendimi mund t’i drejtohet GJEDNJ-së.

14. Në ankimin kushtetues individual kërkesja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, me argumentin se gjykimi i çështjes në gjykatat e zakonshme ka zgjatur rreth 20 vjet, ndërsa në Gjykatën e Lartë rreth 8 vjet.

15. Lidhur me këtë kërkim, Kolegji sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, sipas të cilëve, individët kanë në dispozicion mjetin juridik të kërkesës që u drejtohet gjykatave të zakonshme për përshpejtimin e procedurave dhe konstatimin e shkeljes (nenet 399/1 e vijues të KPC-së). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vëren se kërkesja nuk i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues individual ndonjë akt që të provojë se ka përdorur mjetet ligjore që ka pasur në dispozicion. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.